



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4707 Prot.

Roskovec, më 02, 07 2021

VENDIM

NR. 48 DATË 30.06.2021

***“PËR NJË NDRYSHIM NË LISTËN E INVENTARIT, MIRATUAR ME VKM NR. 770, DATË 24.09.2010 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE ,SHTETËRORE QË TRASFEROHEN NË PRONËSI OSE PËRDORIM TË BASHKISË ROSKOVEC” DHE VKB NR.48 DATË 29.06.2020 “PËR PËRDITËSIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË NDODHEN NË TERRITORIN E BASHKISË ROSKOVEC”***

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, shkronja k); Ligjit Nr.8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.39, datë 31.05.2021 “Për disa ndryshime mbi projektin “Rehabilitimi i Bllokut Nr.1”, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI:**

1- Ndryshimin në :

- Listën e Inventarit të Pronave Publike miratuar me VKM nr.770, datë 24.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Roskovec”, prona me numër rendor 12,zk 3196 me sipërfaqe 16 m<sup>2</sup> , të ndryshohet lloji I pronës nga “truall + ndërtesë” në “truall+ hapësirë e gjelbërt” ,emërtimi i pronës nga “Lapidar” në “Hapësirë e gjelbërt”



**,funksioni për të cilën përdoret prona nga “Përkujtimore” në “Park” dhe fusha e përdorimit të pronës “Infrastruktur dhe shërbime publike”.**

- Në listën e inventarit të pronave publike miratuar me VKB Nr.48, datë 29.06.2020 “Për përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë Roskovec” ,prona me nr. rendor 12 ,me numër pasurie 1/825 ,ZK 3196, indeks harte 199-D, sipërfaqe 16 m2 , të ndryshohet lloji i pronës nga “truall + ndërtesë” në “truall+ hapësirë e gjelbërt” ,emërtimi i pronës nga “Lapidar” në “Hapësirë e gjelbërt”, funksioni për të cilën përdoret prona nga “Përkujtimore” në “Park” dhe fusha e përdorimit të pronës “Infrastruktur dhe shërbime publike”.

2- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për zbatimin e këtij vendimi.

3- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Bashkëlidhur këtij vendimi:

- Lista e Inventarit të Pronave Publike miratuar me VKM nr.770, datë 24.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Roskovec”
- Lista e inventarit të pronave publike miratuar me VKB Nr.48, datë 29.06.2020 “Për përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë Roskovec”.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.39, datë 31.05.2021 “Për disa ndryshime mbi projektin “Rehabilitimi i Bllokut Nr.1”
- Relacion shpjegues
- Planvendosjen
- Formulari për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore

Sasia e ekzemplarëve të shtypur:5

